



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçante



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201402135/3

Tiranë ___/___/2015

Lënda: *Rekomandim për shpejtim gjykimi në çështjen civile me Nr.4346 akti, datë 20014 që i përket ankuesit A. M. nga Tirana.*

Drejtuar : **Z.Alaudín MALAJ**
Kryetar i Gjykatës së Apelit

TIRANË

I nderuar Z. Kryetar,

Në ankesën e tij datë 18.11.2014 drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, shtetasi A. M. nga Tirana ankohet për zvarritje të padrejta të gjykimi të një çështje civile nga Gjykata e Apelit Tiranë, kundra të paditurit “___” sh.a Tiranë, me objekt shpërblimin e dëmeve të rrjedhura nga zgjidhja e menjëhershme dhe pa shkaqe të arsyeshme të kontratës së punës.

Ankuesi A. M. nga ana e tij pretendon se në lidhje me këtë problem ai i është drejtuar rrugës gjyqësore dhe me vendimin gjyqësor civil Nr.3249 datë 10.03.2014 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka vendosur pranimit e pjeshëm të kërkesë-padisë dhe detyrimin e palës së paditur “___”sh.a. Tiranë ta dëmshpërblejë atë, me pagën e 8 muajëve me page mujore 21.000 lekë në muaj si dëmshpërblim për ndërprerjen e mardhënieve të punës në mënyrë arbitrare e të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara. Ndaj këtij vendimi gjyqësor pala e paditur ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe dosja tani ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë me Nr.4346 akti, dhe si gjyqtar relator është caktuar Z.. K.

Duke analizuar kushtet ekonomike dhe familjare të ankuesit A. M. se ai është i martuar me 4 fëmijë të mitur, se vet dhe bashkëshortja e tij nuk janë në mardhënie pune, dhe nuk kanë mjete jetese të mjaftueshme për të jetuar ankuesi pretendon se i është drejtuar me kërkesë për shpejtim gjykimi Kryetarit të Gjykatës së Apelit Tiranë, i cili nuk nuk i ka kthyer përgjigje në bazë të ligjit duke lënë të nënkuptohet se gjykimi i tij duhet të ndjek radhën e gjykimit në bazë të rregullave të parashikuara në ligj.

Ankuesi A. M. nga ana e tij ka kërkuar ndihmën dhe ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit, që rasti i tij të trajtohet si rast i veçantë dhe nga Gjykata e Apelit Tiranë të shikohet mundësia e shpejtimit të këtij gjykimi në të ardhmen.

Nga ana jonë duke analizuar kushtet ekonomike dhe familjare jo të mira të ankuesit A. M., koha e kaluar për rreth 1 vit nga gjykimi nga Gjykata e shkallës së parë Tiranë, çmohet që të ndërhyhet me rekomandim për marrjen e masave për shpejtimin e procedurave gjyqësore duke e konsiderua këtë rast, **si një rast të veçantë** për tu shpejtuar gjykimi në të ardhmen.

Në nenin 63 pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, përcaktohet se: "**Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të drejtave të njeriut, nga administrata publike**". Në nenin 42/2 të kësaj Kushtetute, parashikohet se: "Kushdo për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjor, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanëshme e caktuar me ligj".

Në nenin 25 paragrafi i fundit i Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", pasrashikohet se: "**Avokati i Popullit, pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkeljen e të drejtave të njeriut që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit**".

Për të gjitha këto arsye, Ju

REKOMANDOJMË :

1. Të shikohet mundësia ligjore e shpejtimin të gjykimit të çështjes civile me Nr.4346 akti, me paditës ankuesin A. M. nga Tirana.

2. Mbi shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe masat e marra nga ana juaj, lutemi na njoftoni me shkrim brenda 30 ditësh.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI